



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), Neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës për punën e Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar ndaj lëndës së formuar pas denoncimit të parashtruar, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në vazhdimin e seancës së 60-të, të mbajtur më 31.01.2022, miratoi si në vijim.

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-1663/1 e datës 22.04.2021, e cila shpreh pakënaqësi për punën e ish-kryetarit të komunës në datën -----, ----- и **REFUZOHET.**

KSHPK përcaktoi se sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin e lëndës.

Lënda me numër 12-1663/1 të datës 22.04.2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Nga parashtruesi i njohur, më datë 22.04.2021 është dorëzuar një denoncim në të cilën shpreh pakënaqësi për punën e ish-kryetarit të komunës në datën -----, ----- dhe është formuar lënda me numër 12-1663 / 1 nga 22.04.2021.

Në denoncim, parashtruesit raportojnë se pas një takimi të kërkuar nga kryetari i komunës -----, kryetari i komisionit për urbanizëm, kryetari dhe anëtarët e Këshillit të cilëve donin t'i raportonin problemet e banorëve të vendbanimit --- -----, nuk kishin përgjigje. Pastaj ata i rendisin problemet në vendbanim: Ndryshimi i planit të detajuar urban, ndërtimi i parkut dhe këndeve të lojërave, ndërtimi i parkingjeve të reja, zgjerimi i një rruge të sapo asfaltuar, problemet me trotualet, inspektimi i banesave nuk funksionoi.

Pas shqyrtimit të pretendimeve të lëndës, KSHPK konstatoi se nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë, përkatësisht të gjitha problemet e cekura në denoncim janë përgjegjësi e Komunës së -----.

Në bazë të lartpërmendurës, KSHPK-ja vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Pёrgatiti: S.M

Miratoi: Mr. SH.S anёtar i KSHPK-sё

КОМИСИОН ШТЕТЌОРОР
ПЃР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ
Nёnkryetar
Goran Trpenoski

